



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

L ë n d a: Mbledhja e Komisionit Kombëtar të Nomenklaturave

KKN

Minutat e takimit

Datë 11.06.2024

Më datë 11 qershor u zhvillua mbledhja e Komisionit Kombëtar për Nomenklaturat (KKN). Axhenda e takimit ishte:

1. Vënia në dispozicion e materialeve në versionin shqip të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (të rishikuar), versioni NVE Rev 2.1;
2. Diskutime mbi planin e trajnimeve mbi vënien në zbatim të NVE Rev 2.1;
3. Çështje të tjera.

Kryetarja e KKN, Znj. Elsa Dhuli bëri prezantimin e rendit të ditës e cila u miratua pa ndryshime. Takimi vijoi sipas axhendës.

Vënia në dispozicion e materialeve në versionin shqip të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (të rishikuar), versioni NVE Rev 2.1

Znj. Dhuli, referoi që Komisioni Evropian po bën rishikimin e të gjithë klasifikimeve, duke e filluar me Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike, për të vijuar më tej me Nomenklaturën e Produkteve, Nomenklatura e Konsumit Individual sipas Qëllimit, Klasifikimin Statistikor Ndërkombëtar të Sëmundjeve etj.

Komisioni Evropian, grupi i punës për klasifikimet dhe nomenklaturat pranë EUROSTAT, ka miratuar versionin NVE Rev 2.1. Baza ligjore përkatëse që shoqëron nomenklaturën si strukturë, notën shpjeguese dhe do të fillojë zbatimin për vendet e bashkimit evropian në janar të vitit 2025. Duke qenë se është një akt rregullator i bashkimit evropian, përkthimi i nomenklaturës NVE Rev 2.1 është planifikuar si akt ligjor i cili do të shoqërohet me një vendim të Këshillit të Ministrave. Në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian, PKIE 2023-2025, ky klasifikim është planifikuar të miratohet gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2025. Është kusht i domosdoshëm që në 4-mujorin e parë të vitit 2025 klasifikimi të miratohet me vendim të KM.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

ëëë.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Versioni anglisht i NVE Rev 2.1 është përkthyer në shqip nga stafi ekspert i INSTAT e tanimë draft versioni shqip do ju vihet në dispozicion anëtarëve të KKN-së për tu rishikuar dhe për të bërë komentet ose ndryshimet e nevojshme (në rast se ka). Fokusi kryesisht do të jetë në terminologjinë e përdorur, pra anëtarët kontributin e tyre do e ofrojnë pikërisht në saktësimin e disa fjalëve/fjalive të cilat kanë një terminologji specifike. Më tej Z. Ervin Zeka, specialist në sektorin e Regjistrat Statistikor të Ndërmarrje pranë INSTAT shpjegoi më konkretisht punën teknike të kryer nga stafi ekspert i INSTAT për përkthimin në gjuhën shqip të versionit të rishikuar të NVE Rev 2.1. Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike është e përbërë nga 22 seksione dhe niveli më i detajuar është në nivel 4-shifror.

Në vijim Znj. Dhuli shpjegoi që NVE Rev 2.1 është baza për ndarjen e strukturës ekonomike. Nga ana e statistikave, por dhe në nivel ekonomie vendi, të gjithë aktivitetet Bujqësi, Industri dhe Ndërtim janë aktivitete prodhuese të të mirave dhe të gjithë aktivitetet e tjera, Tregtia, Akomodimi, Transporti, Informacioni e Komunikacioni dhe Shërbime të tjera janë pjesë e kategorisë së prodhuesve të shërbimeve. Të gjitha ndryshimet në nomenklaturë kanë ardhur si rrjedhojë e ndryshimeve botërore ku dhe Shqipëria e gjen veten në këto ndryshime.

Znj. Dhuli u ndal në një shembull (nivel kombëtar) për të ilustruar rastet nëse një ministri/institucion dëshiron të shtojë një aktivitet ekonomik i cili nuk e gjen veten ende në Nomenklaturën e rishikuar NVE Rev 2.1. Nëse në bujqësi janë të zhvilluar fermat organike, pesha e të cilave në aktivitetin e bujqësisë zë 1% të prodhimit të brendshëm bruto dhe duhet të reflektohet por nuk e gjen veten saktësisht të shprehur në nomenklaturë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka të drejtën e sjelljes së propozimit në Komision për një detajim të këtij aktiviteti nëse Ministria dëshiron që ky aktivitet të identifikohet dhe të vihet në dukje. Kjo gjë vlen dhe për aktivitete të tjera nga ministrinë ose institucione të tjera. Propozime për aktivitete të reja do sillen pranë komisionit për tu shqyrtuar më tej. Nëse miratohen do të kalohet në një version kombëtar të NVE Rev. 2.1(detajim 5 shifror) që do të jetë i dallueshëm nga versioni evropian (detajim 4 shifror).

Në rast se të gjitha aktivitetet ekonomike që kryhen dhe realizohen në Shqipëri e gjejnë veten në këtë klasifikim evropian atëherë ne do raportojmë në Komisionin Evropian që Shqipëria përdor dhe zbaton versionin identik evropian të NVE Rev. 2.1. Gjithashtu do raportojmë dhe në rastin kur kemi një nomenklaturë të adaptuar sipas nevojave kombëtare.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

ëëë.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Znj. Dhuli në vijim propozoi që në fund të korrikut (pasi të jenë mbledhur komentet nga anëtarët) të kryhet një takim në mënyrë që të analizohen dhe të merret një vendim për komentet e dërguara.

Znj. Kureta përfaqësuese nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive ngriti shqetësimin mbi Agjensinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, AKSHI. Znj. Kureta shtoi që, të gjitha informacionet për nomenklaturat janë në sistemet tona dhe të gjitha ndërhyrjet në to duhen bërë me miratimin e AKSHI-t. Institucionet janë vendim-marrëse ndërkohë që AKSHI është implementuesi i ndryshimeve që ndodhin në sistem. Gjatë diskutimeve u propozua që në mbledhjen e ardhshme të ftohet dhe një përfaqësues nga AKSHI ku ti prezantohet puna që po kryhet nga Komisioni, e gjithashtu të jap një opinion mbi procedurat që duhet të ndiqen në mënyrë që këto ndryshime të implementohen në sistem.

Diskutime mbi planin e trajnimeve mbi vënien në zbatim të NVE Rev 2.1

Në vijim Znj. Dhuli u ndal në trajnimet e stafit të institucioneve që preken nga rishikimi i NVE Rev.2.1. Pas grumbullimit të komenteve nevojitet dërgimi me email me shkresë zyrtare i nevojave për trajnim të stafit. Znj. Dhuli propozoi që stafi në ministritë ose institucionet që janë të angazhuar me statistika të trajnohen për nomenklaturën. Trajnimi që do të kryhet për QKB dhe DPT do të jetë më i detajuar, sepse në këto dy institucione trajnohen të gjithë punonjësit që kodifikojnë bizneset e reja që hapen dhe do rikodifikojnë bizneset stok. Deri në fillim të muajit shtator duhen dërguar nevojat për trajnim të stafit në mënyrë që të kryhet dhe grafiku i trajnimeve.

Miratimi i planit të aktiviteteve të KKN për vitin 2024

Anëtarët e KKN-së miratuan planin e aktiviteteve, i prezatuar nga INSTAT në takimin parardhës dhe i rishikuar nga të gjithë anëtarët. Plani i aktiviteteve për vitin 2024 fokusohet kryesisht në rritjen e kapaciteteve të administratës publike, duke organizuar trajnime.

Përgatiti:

Sekretariati i KKN
20 Qershor 2024

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

ëëë.instat.gov.al / info@instat.gov.al